

Sektori i veprave civile të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në bazë të nenit 68 nga Rregullorja gjyqësore ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 66/2013 dhe 114/2014), dhe nenit 31, nenit 32 dhe nenit 33 nga Rregullorja e punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 14/2022 të datës 20 janar 2022), pas seancës së mbajtur për çështjen juridike për zbatimin e nenit 111 paragrafi (4) të Ligjit për nëpunësit administrativ, në lidhje me të drejtën e shtesës së rrogës në bazë të karrierës ("Gazeta Zyrtare e RM" numër 27 të datës 05.02.2014), për unifikimin e praktikës gjyqësore ndërmjet këshillave të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në seancën e këshillit të mbajtur më 12.07.2022 nxori këtë:

MENDIM JURIDIK

Me avancimin e nëpunësit administrativ ndërpritet shtesa për shkallën e karrierës të shënuar me Ligjin për nëpunësit shtetëror, për arsye se sipas Ligjit për nëpunësit administrativ, shtesa për shkallë të karrierës në vlerë vendoset në pjesën e rrogës për nivelin nga neni 87 paragrafi (3) të ligjit të theksuar në të cilin është sistemuar nëpunësi i avancuar administrativ.

A r s y e t i m

Në pajtim me nenin 111 paragrafi (4) të Ligjit për nëpunësit administrativ, nëpunësit shtetëror të cilit deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, i paguhet shtesë për shkallë të karrierës në pajtim me Ligjin për nëpunësit shtetëror, shuma e shtesës për shkallë të karrierës do t'i përlogaritet si pikë plotësuese në vlerë të shtesës së paguar, në pjesën e rrogës për nivelin nga neni 87 paragrafi (3) të këtij ligji.

Me ligjin e theksuar për nëpunësit administrativ që zbatohet nga muaji shkurt 2015 ndërpritet shtesa e shkallës së karrierës të shënuar me Ligjin për nëpunësit shtetëror, përkatësisht në pajtim me nenin 111 paragrafi (1) të Ligjit për nëpunësit administrativ, zbatimi i mëtejshëm i Ligjit për nëpunësit shtetëror ka të bëjë vetëm për procedurat e filluara në lidhje me punësimin me dhe pa punë provuese, procedurat disiplinore dhe procedurat për vlerësim, nga përmbajtja e dispozitave të theksuara buron se nuk ka mundësi ligjore që nëpunësit të avancuar administrativ ti paguhet shtesë për shkallë të karrierës të shënuar me Ligjin për nëpunësit shtetëror dhe se shtesa e shkallës së karrierës me avancimin e nëpunësit administrativ në vlerë

vendoset në pjesën e rrogës për nivelin nga neni 87 paragrafi 3 të Ligjit për nëpunësit administrativ në të cilin është sistemuar nëpunësi administrativ.

Gjykata Supreme e
Republikës së Maqedonisë së Veriut
Sektori i veprave civile